

# *Bashkimi familjar si një e drejtë themelore në ditët e sotme*

*Dr. Greta Bardeli*

*Prof. Asoc. Dr. Erjona Canaj*

## **Abstrakt**

*Familja është njësia bazë e shoqërisë dhe e drejta e bashkimit familjar është një nga të drejtat më të rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë. Në fakt, kjo e drejtë merr një rëndësi të veçantë në kauder të emigracionit, sidomos për shoqërinë shqiptare në këto dy dekadat e fundit. Mbrojtja e kësaj të drejte është domosdoshmëri për ruajtjen e unitetit familjar. E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore e sanksionuar në shumë akte ligjore ndërkombëtare, rajonale dhe europiane. Kjo është një e drejtë shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi, si dhe në mënyrë të veçantë në kuadër të ruajtjes së unitetit familjar.*

*Nëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi i njihet e drejta për t'u bashkuar me anëtarët e familjes së tij në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. Në përgjithësi, bashkimi familjar, nëse nuk ka ndonjë regjim tjetër specifik, i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Me natyrë të veçantë prezantohet rendi juridik i Bashkimit Europian, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar. Bashkimi familjar në BE njihet si titullar aktiv si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar. Në BE e drejta për bashkim familjar si e drejtë themelore parashikohet në direktivën 2003/86/KE, mbi bashkimin familjar për shtetasit jo komunitarë që gjenden në territorin e BE-së për arsye punësimi dhe në direktivën 2004/38/KE mbi lëvizjen e lirë për shtetasit komunitarë.*

*Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në vendin tonë: është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën juridike të bashkimit familjar të shtetasve të huaj që kërkojnë bashkim familjar në territorin e*

*Republikes së Shqipërisë siç janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit. Në këtë drejtim legjislativi ynë mbi bashkimin familjar prezantohet në përputhje me standartet europiane.*

**Fjalët kyçe:** bashkim familjar, familje, të huaj, familjarë, e drejtë themelore, legjislativi shqiptar.

## 1. Hyrje

E drejta e bashkimit familjar aktualisht gëzon mbrojtje ligjore jo vetëm në nivel kombëtar dhe rajonal, evropian, por edhe ndërkombëtar. Garantimi i kësaj të drejte krijon mundësinë e bashkimit të personave me anëtarët e familjeve të tyre të cilët ndodhen në një shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. E drejta për bashkim familjar është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në kuadër të lëvizjes së lirë dhe të emigracionit në përgjithësi<sup>1</sup>. Nëpërmjet institutit të bashkimit familjar një personi i njihet e drejta për t'u bashkuar me anëtarët e familjes së tij në një Shtet të ndryshëm nga ai i vendlindjes. Në përgjithësi, bashkimi familjar, nëse nuk ka ndonjë regjim tjetër specifik i nënshtrohet rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Me natyrë të veçantë prezantohet rendi juridik i Bashkimit Europian, ku bashkimi familjar merr ngjyra të ndryshme në varësi të statusit të personit që kërkon bashkim familjar. Bashkimi familjar në BE njihet si titullar aktiv (personin që transferohet në një shtet tjetër anëtar -shteti pritës- dhe që kërkon bashkimin me familjen e tij që ndodhen në shtetin prej të cilit vjen – shteti i vendlindjes) si shtetasin komunitar ashtu edhe atë jo komunitar. Në këtë studim do të fokusohemi në mënyrë të veçantë në disiplinën e bashkimit familjar si për shtetasit komunitar ashtu edhe ata jo komunitar dhe në përcaktimin e kategorive të familjarëve që e përfitojnë këtë të drejtë, si dhe rregullimin juridik të bashkimit familjar në Shqipëri.

Të drejtën e bashkimit familjar e gjejmë të trajtuar fillimisht në dispozitat e Traktatit Themelues të Komunitetit Europian dhe në legjislativin sekondar të institucioneve komunitare. Në Europë, bashkimi familjar merr rëndësi si pasojë e krijimit të hapësirës së përbashkët, që përcakton jo vetëm flukset e punonjësve emigrantë, por përcakton në mënyrë shumë rigorozë dhe selektive mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit, me preferencë për qëndrimin e përkohshme. Karakteristikat

<sup>1</sup> Deklarata universale e të drejtave të njeriut (neni 12 dhe 16), Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike (17 dhe 23) dhe Pakti ndërkombëtar për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 2) Konventa ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës (nenet 9 dhe 10), Konventa europiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut (neni 8) Karta sociale europiane (nenet 16 dhe 19) Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre (neni 44), Konventa europiane për statusin ligjor të punëtorëve migrantë (neni 12), Karta e të drejtave themelore të Bashkimit Europian (neni 7) etj.

e flukseve migratore kanë qenë gjithmonë të ndryshme në kohë dhe për rrjedhojë kanë marrë rëndësi të ndryshme në varësi të kontekstit historik. Lëvizja e personave para viteve '90 ishte kryesisht brenda vendit dhe pas këtyre viteve filluan të shfaqeshin format e para të emigracionit ekonomik drejt vendeve të tjera. Fluksi më i madh i emigracionit ekonomik ishte pas Luftës së Dytë Botërore dhe kishte si qëllim rindërtimin ekonomik të shkatërruar nga Lufta. Pikërisht ishte kjo lëvizje migratore e cila krijoi konceptin e *guest worker*.

Një pjesë e konsiderueshme e personave emigronin vetëm dhe bashkimi i familjes, me familjarin e mbetur në vendin e origjinës, realizohej nëpërmjet nismave spontane të disa qytetarëve që i përkushtoheshin bashkimit të familjeve të ndara, edhe pse në mungesë të normativave në këtë fushë. Me evoluimin e ekonomisë dhe të shoqërisë civile evoluoi mbrojtja dhe rregullimi ligjor i të drejtës së bashkimit familjar, duke arritur një standardizim më të lartë

E drejta për bashkim familjar për shtetasit komunitarë merr rëndësi për të drejtën komunitare vetëm atëherë kur personat që shoqërojnë familjarin e tyre transferohen dhe qëndrojnë në një Shtet tjetër Anëtar për një periudhë më të gjatë se tre muaj: pra, bashkimi familjar për një familje të përbërë vetëm nga shtetas komunitarë mund të realizohet *de facto* për një periudhë kohe deri tre muaj, pasi për këta individë aplikohet regjimi i përgjithshëm i lëvizjes së lirë afatshkurtër. Në lidhje me lëvizjen e lirë dhe me bashkimin familjar, është shumë e rëndësishme direktiva e Këshillit dhe e Parlamentit Europian e dt. 29 prill 2004 nr. 2004/38/KE<sup>2</sup> e cila përfshin gjithë disiplinën e qarkullimit të lirë të shtetasve komunitarë në territorin e secilit prej Shteteve Anëtare të BE-së. Direktiva 2004/38 përmbledh në një instrument të vetëm ligjor përmbajtjen e rregullave për hyrjen dhe qëndrimin e personave të vetë-punësuar, personave të punësuar, studentëve, si dhe personave që nuk janë ekonomikisht aktivë dhe familjarët e tyre, duke e zgjeruar këtë të drejtë

<sup>2</sup> Direktiva në fjalë amendoi rregulloren n.1612 e 15 tetor 1968 e cila shënoi liberalizimin e plotë në qarkullimin e punëtorëve me kontratë dhe shfuqizoi direktivën n. 360 e 15 tetor 1968; rregulloren n. 1048/71 e 14 qershorit 1971 mbi sigurimet e cila synonte një harmonizim të të gjitha legjislativëve të Shteteve Anëtare; direktivën 98/49/CE e 29 qershorit 1998, me anë të së cilës disiplina komunitare u aplikua edhe për regjimet e pensione; direktivën 73/148/KEE që kishte të bënte me heqjen e pengesave në transferimin dhe të drejtën e leje-qëndrimit e shtetasve të një Shteti Anëtar të BE-së në fushën e vetë-punësimit dhe të shërbimeve; rregulloren n.1251/70 dhe direktivën 75/34 të cilat parashikonin kushtet që duhen plotësuar nga punëtorët me pagesë dhe familjarët e tyre për të drejtën e qëndrimit të përhershëm kur nuk punojnë më për arsye të ndryshme si moshë, arsye shëndetësore etj.; direktivën 75/34/KEE e 17 dhjetorit 1974, e cila parashikonte që t'u aplikohen edhe punëtorëve që vetë-punësohen, pasi kanë përfunduar punën për arsye të moshës ose invaliditetit (dhe familjarëve të tyre) të drejtën për leje qëndrimi ashtu sikurse parashikohet për punëtorët në përgjithësi si dhe direktivat 90/364, 90/365, 93/96, të vitit 1990 lidhur me lëvizjen e lirë të personave jo aktivë ekonomikisht, të studentëve dhe të pensionistëve. C.SANNA, *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167; M.MISSORICI-C.ROMANO, *Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni*, në *Rivista internazionale dei diritti dell'uomo*, n. 11/98, fq. 44.

themelore dhe zbatueshmërinë e këtij ligjislacioni tek të gjithë qytetarët e BE-së që ushtrojnë të drejtën e qarkullimit të lirë dhe rezidencës.

Kjo Direktivë nuk zbatohet për të gjithë qytetarët e Shteteve Anëtare të BE-së, por vetëm për ata subjekte që ushtrojnë efektivisht të drejtën e lëvizjes së lirë: ajo shtrihet te qytetarët e BE-së të cilët transferohen në një shtet tjetër për disa arsye, d.m.th. për arsye të ndryshme nga ato vetëm “të punësimit”. Rregullat e reja janë hartuar gjithashtu për të inkurajuar qytetarët e BE-së në ushtrimin e të drejtës së tyre për të lëvizur dhe qëndruar lirisht në territorin e Shteteve Anëtare, për të hequr formalitetet administrative të ndërlikuara përkundrejt atyre me të thjeshtave, si dhe për të siguruar një përcaktim më të mirë të statusit të anëtarëve të familjes në gëzimin e këtyre të drejtave. Në këtë kuadër vlen të theksohet se e drejta për bashkim familjar për shtetasit komunitarë merr rëndësi për të drejtën komunitare vetëm atëherë kur personat që shoqërojnë familjarin e tyre qëndrojnë në një Shtet tjetër Anëtar për një periudhë më të gjatë se tre muaj. Bashkimi familjar në qëndrimet afatgjata (më shumë se tre muaj) rregullohet nga dispozitat e direktivës 2004/38. Në këto norma rezulton se familja, e përbërë nga individë-shtetas komunitarë prezantohet më e plotë dhe më e mbrojtur pikërisht për faktin se e drejta për bashkim familjar ushtrohet në plotësim të një të drejte tjetër themelore që është ajo e lëvizjes së lirë, një liri themelore kjo e garantuar dhe e respektuar maksimalisht në Bashkimin Europian.

Bashkimi familjar i shtetasve jo komunitarë i është nënshtruar gjithmonë legjislacionit të brendshëm i painfluencuar nga e drejta komunitare pasi në legjislacionin europian mungonin akte ligjore që rregullonin institutin e bashkimit familjar. Vetëm në vitin 2003 në Bashkimin Europian arrihet rregullimi ligjor komunitar i bashkimit familjar i shtetasve jo komunitarë që gjenden në territorin e BE-së. Bashkimi familjar ku titullar aktiv është shtetasi jo komunitar që jeton dhe punon në një Shtet Anëtar të BE-së, aktualisht rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i shteteve anëtare në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian 2003/86/KE<sup>3</sup>. Direktiva 2003/86 u drejtohet shtetasve jo komunitarë që gjenden në territorin e një Shteti Anëtar për motive punësimi dhe për refugjatët. Direktiva është instrumenti i parë ligjor i BE-së në lidhje me emigrimin e ligjshëm, dhe si pasojë për disa vende anëtare ishte hera e parë që u pajisën me një set rregullash mbi të drejtën për bashkim familjar në legjislacionin e tyre kombëtar. Implementimi i direktivës në praktikë ka hasur në probleme në vende të caktuara, si p.sh. në lehtësimin e regjimit të vizave, dhënien automatike të lejeve të qëndrimit, marrjen parasysht të interesit më të mirë të fëmijës etj. Nëpërmjet kësaj direktive përcaktohen rregullat kryesore për ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar si dhe përcaktohen për herë të parë në nivel europian cilët janë personat që e përbëjnë një familje.

<sup>3</sup> COLACINO N., *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE* në Saulle M.R., *L'Europa tra costituzione, asilo e immigrazione*, Napoli, 2004.

## 2. Statusi i familjarit në të drejtën komunitare në kuadër të bashkimit familjar

Familja, në kuadër të bashkimit familjar prezantohet si një strukturë me gjeometri variabel: dmth ka një bërthamë të fortë dhe solide siç është familja nukleare (prindër/fëmijë të mitur), por ka edhe një pjesë heterogjene, e cila sheh si familjarë edhe pjesëtarë të tjerë (fëmijë në moshë madhore, partnere, gjyshër, vëllezër, motra etj.) të cilët përcaktohen vetëm në bazë të legjislacionit të brendshëm të Shtetit pritës.

Bashkimi familjar realizohet për shtetasit komunitarë si për qëndrime afatshkurtra ashtu edhe për qëndrime afatgjata (periudha tre muaj, tre muaj deri në pesë vjet dhe mbi pesë vjet). Shtetasit jo komunitarë e ushtrojnë këtë të drejtë vetëm për qëndrimet afatgjata, pra, vetëm për ata persona të cilët janë në posedim të një leje qëndrimi me kohëzgjatje minimumi një vjeçare dhe me perspektivën e një leje qëndrimi të vazhdueshme. Kjo, në fakt, edhe pse është kufizuese në thelb, mund të themi që është një zgjidhje e arsyeshme pasi emigracioni kërkon stabilitet dhe integrim familjar në qëndrime afatgjata.

Familja tradicionale sheh bashkëshortin/en si një komponent themelor të saj. Të dy kategoritë e familjeve e shohin në të njëjtën mënyrë. Ajo që i dallon është vetëm një specifikë që lidhet me moshën. Bashkëshorti shtetas komunitar nuk ka një kufi për moshën në ushtrimin e të drejtës së bashkimit familjar, pra nuk është vënë për të kufiri në moshën 21 vjeç për ushtrimin e kësaj të drejte, siç është vënë për shtetasin jo komunitar. Në të vërtetë, martesat e shtetasve komunitarë në moshë më të vogël se 21 vjeç janë shumë të pakta, për të mos thënë të rralla. Dispozitat e Direktivës 2003/86 e vendosin këtë kufi për shtetasit jo komunitarë për të luftuar praktikën e martesave mes të miturve pa pëlqimin e tyre të lirë. Ky kufi moshe tenton që të parandalojë martesat të detyruara dhe të sigurojë integrim më të mirë. Në qoftë se duket qëllim legjitim dhe i drejtë kriteri i parë, nuk duket i tillë ose i realizueshëm i dyti.

Direktiva 2003/86 pranon një nocion të familjes që është më e ngushtë (kufizuar) se ajo e specifikuar në Direktivën 2004/38. Duke iu referuar nocionit të përgjithshëm të familjes, sot të pranishme në Evropë janë prezent modele të ndryshme familjare. Modeli që konsiderohet të jetë modeli i “familjes europiane”, pra familja e vogël, sot është duke kaluar nëpër ndryshime të thella. Për rregullimin e të drejtave (p.sh. në kuadrin e bashkimit familjar) të të huajve që vijnë nga shoqëri ku sistemet e familjes janë shoqërisht dhe juridikisht të ndryshme nga ajo që dominon në kodet ‘evropiane’, është e nevojshme që këta emigrantë të “përshtaten” me modelin e “familjes europiane” marrë në kuptimin e saj me të ngushtë, pra një

familje e vogël, e përbërë nga bashkëshorti/ja dhe fëmijët e mitur. Qëllimi në këto raste është që të kristalizohet koncepti i familjeve të emigrantëve në funksion të asaj që konsiderohet “familja tradicionale europiane”.

Për shtetasit komunitarë, brenda konceptit të familjes, për të cilat shteti është i detyruar të autorizojë hyrjen, përfshihet edhe partneri, i cili ka mbrojtje më të garantuar nëse e ka “legalizuar” marrëdhënien e tij me shtetasin komunitar. Në këtë drejtim familja komunitare ka një element të ri në përbërjen “tradicionale”, që legjislatori komunitar është i vendosur me të gjitha mjetet e nevojshme ta mbrojë. Kuptohet që partneri i cili nuk e ka “legalizuar” marrëdhënien, pra nuk e ka regjistruar në zyrat e gjendjes civile ose ai që është i tillë në vende ku kjo nuk parashikohet, gëzon një mbrojtje më të dobët e cila përkthehet në “mundësinë e hyrjes dhe qëndrimit” në territorin e shtetit pritës dhe jo në “hyrje dhe qëndrim të pakushtëzuar”. Në këtë drejtim kjo kategori partnerësh nuk gëzon të drejtën e menjëhershme për të shoqëruar apo për t’u bashkuar me punëtorin migrant. Të drejtat e tyre të hyrjes dhe qëndrimit varen nga diskrecioni i Shteteve Anëtare. Në thelb, Direktiva 2004/38 duket se ka kontribuar në rritjen e mbrojtjes së partnerëve të regjistruar më tepër se ata që thjesht bashkëjetojnë. Direktiva 2003/86 nuk e konsideron partnerin anëtar të sigurt të një familje sipas kushteve të njëjta të direktivës 2004/38. Megjithatë, duket interesante në këtë drejtim, hapja për një partner bashkëjetues, edhe pse ky ekuacion është pranuar vetëm nëse është e parashikuar nga legjislacioni kombëtar.

Në kategorinë e anëtarëve të familjes së pranuar në bazë të bashkimit familjar sipas direktivës 2004/38 përfshihen paraardhësit dhe pasardhësit ndërsa Direktiva 2003/86 i referohet shprehimisht prindërve të titullarit -gjyshërit e shkallës së parë dhe fëmijët. Paraardhësit e titullarit ose të bashkëshortit të shtetasit jo komunitar janë identifikuar vetëm babai dhe nëna e titullarit aktiv. Për këtë kategori, si në njërin rast ashtu edhe në rastin tjetër duhet të ekzistojë kushti i varësisë ekonomike që i sheh të lidhur ekonomikisht këta persona me titullarin aktiv të bashkimit familjar. Fëmijët deri në moshën 21 vjeç, konsiderohen anëtarë të familjes së shtetasve komunitarë, në dallim nga fëmijët e shtetasit që vjen nga vendet e treta, të cilët konsiderohen për qëllime të bashkimit familjar, anëtarë të familjes vetëm nëse janë nën 18 vjeç. Fëmijët mbi 18 vjeç të shtetasve jo komunitarë mund të kenë të drejtë për bashkim familjar, sipas vullnetit të shtetit në fjalë. Kjo rrjedh nga fakti se Direktiva 2003/86 këtë kategori e ka lënë në diskrecionin e Shteteve Anëtare. Direktiva 2003/86 gjithsesi parashikon për fëmijët e rritur të pamartuar (pra, fëmijët në moshë më të madhe se 18 vjeç) një *opsion* për pranimin e tyre nëse për arsye objektive mund të jenë të paaftë për të plotësuar nevojat e tyre personale për shkak të gjendjes shëndetësore.

Direktiva 2004/38, në kategorinë e familjarëve të tjerë që mund të shoqërojnë ose të bashkohen me shtetasin komunitar, ka përfshirë edhe çdo familjar tjetër dhe

kushti i vetëm që duhet të ekzistojë është që të jetë në ngarkim ose të jetonte me të në vendin e origjinës ose kur shkaqe të rënda shëndetësore kërkojnë shtetasin e BE-së që ta ndihmojë atë personalisht. Është e vërtetë se të afërmit e tjerë nuk kanë të drejtën automatike të hyrjes dhe të qëndrimit, së bashku me shtetasin komunitar anëtarë të familjes së tyre, megjithatë, kanë të drejtë që t’u lehtësohet hyrja dhe qëndrimi në Shtetin Anëtar pritës, nëse ata janë të varur ekonomikisht ose kur shkaqe të rënda shëndetësore kërkojnë që personi të ndihmohet nga shtetasi komunitar.

Të drejtat e anëtarëve të familjes së pranuar për bashkim familjar janë e drejta e qëndrimit, e drejta për arsim, e drejta për punë (me kontratë ose vetë-punësim), si dhe të drejtat që kanë të bëjnë me formimin profesional dhe trajnimet e ndryshme. Këto të drejta, në përgjithësi, janë parashikuar në të dy aktet ligjore që analizuam.

### 3. Legjislacioni shqiptar lidhur me bashkimin familjar në përputhje me standartet e BE-së

Bashkimi familjar është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtetasit e huaj titullarë aktivë të bashkimit familjar janë refugjatët, të punësuarit dhe të vetëpunësuarit.

Burimet kryesore të së drejtës për bashkim familjar dhe unitet familjar të të huajve të vendin tonë janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”, Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfutur azil në Republikën e Shqipërisë”. Legjislacioni ynë prezantohet në përputhje me standartet europiane.

Familja si njësi natyrore duhet t’i garantohet kujtdo dhe në fakt, kushdo ka të drejtën të ketë një familje, sanksionuar në nenin 53 të Kushtetutës. Kjo e drejtë prashikohet edhe për të huajt që gjenden në Shqipëri. Kushtetuta e ka përcaktuar qartë në nenin 16 se “Të gjitha të drejtat dhe liritë themelore si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë vlejnë njëjloj edhe për të huajt dhe personat pa shtetësi që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë, përveç rasteve kur Kushtetuta e lidh ushtrimin e tyre në mënyrë të posaçme me shtetësinë”<sup>4</sup>. Kuadri ligjor që respekton të drejtën për bashkim familjar, në përputhje me parimet kushtetuese dhe direktivën 2003/86/KE përmbahet në Ligjin e ri për të huajt nr. 9959 i miratuar në vitin 2008. E drejta për bashkim

<sup>4</sup> OMARI-A.ANASTASI, *E drejta kushtetuese*, Tiranë, 2008; L.IKONOMI, *E drejta e migracionit*, Tiranë, 2011, fq. 102.

familjar rregullohet shprehimisht në nenin 32 të këtij ligji<sup>5</sup>. Kjo e drejtë i njihet çdo të huaji që ka hyrë dhe qëndron në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe është i pajisur me leje qëndrimi me kohëzgjatje jo më të vogël se një vit. Në bazë të nenit 3, anëtarë të familjes janë bashkëshorti/ bashkëshortja, fëmijët nën moshën 18 vjeç, fëmijët e birësuar ose në kujdestarinë e të huajit, fëmijët e bashkëshortit/bashkëshortës së tij/saj, prindërit e moshuar, në ngarkim të të huajit.

Kërkesa për bashkim i referohet familjes që buron nga martesë monogame. Përjashtohet në këtë kategori partneri. Në rast të të huajve që vijnë nga një vend ku poligamia është e ligjshme, i huaji që kërkon bashkim familjar duhet të zgjedhë vetëm një nga bashkëshortet. Zgjidhja për këta anëtarë të familjes është në përputhje të plotë me legjislacionin komunitar, madje shkon edhe më tej, duke lejuar edhe prindërit nëse janë në ngarkim.

Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6 përcakton se “Të drejtën e azilit, me të njëjtin status, e përfitojnë edhe bashkëshorti, fëmijët e moshës nën 18 vjeç dhe çdo i afërm në ngarkim ligjor i refugjatit, të cilit i është dhënë azil, me kusht që ata të jetojnë së bashku”. Ligji në fjalë parashikon gjithashtu që fëmijët mbi moshën 18 vjeç nuk mund të përfitojnë azil, në bazë të bashkimit familjar, vetëm në rast kur ai/ajo është në ngarkim ligjor të prindërve të tij refugjatë të cilëve u është dhënë azil në vendin tonë. Në këto raste personi në fjalë duhet të paraqesë personalisht një kërkesë individuale.

Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare dhe europiane dhe me qëllim integrimin sa më të plotë të tyre, është miratuar Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Per integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”. Bashkimi familjar rregullohet në Kreun VI, në nenet 26-34. Në lidhje me përbërjen e familjes, neni 26 specifikon që: “Personi, që ka përfituar azil në Republikën e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë bashkim familjar me bashkëshortin ose bashkëshorten, fëmijët e pamartuar nën 18 vjeç ose ndonjë person tjetër në ngarkim të tij”.

<sup>5</sup> Sipas këtij neni: “1. I huaji, i pajisur me leje qëndrimi, i cili qëndron dhe punon në Republikën e Shqipërisë, mund të bëjë kërkesë pranë Policisë Kufitare dhe Migracionit, vendore, për të sjellë familjen, për efekt të ribashkimit familjar, nëse plotëson kushtet e mëposhtme: a) ka hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji; b) qëndron prej jo më pak se 1 vit në Republikën e Shqipërisë; c) siguron jetesën, në mënyrë të rregullt, në Republikën e Shqipërisë nga të ardhurat apo pronat e bashkëshortit, që qëndron në Republikën e Shqipërisë ose, në rastin e të miturve, nga të ardhurat apo pronat e prindërve; ç) derdh kontribute në sigurimet shëndetësore, për të mbuluar shërbimet e kujdesit shëndetësor; d) garanton mjedise dhe kushte të përshtatshme qëndrimi për familjen; dh) paraqet dokumentacionin, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave. 2. Leja e qëndrimit për ribashkim familjar jepet për një periudhë kohe jo më shumë se leja e qëndrimit të personit, i cili bën kërkesën për ribashkim familjar. 3. Në rast se i refuzohet dhënia e lejes për ribashkim familjar, i huaji ka të drejtë të ankohet pranë ministrit brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit me shkrim”.

Për të huajt shtetas komunitare që vijnë në Shqipëri Ligji përcakton si anëtarë të familjes:

- (a) bashkëshortin ose bashkëshorten;
- (b) partnerin me të cilin shtetasi komunitar bashkëjeton (*more uxorio*) nëse ata janë të regjistruar, në zyrat e gjendjes civile në bazë të legjislacionit të një Shteti Anëtar, nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar pritisë i trajton bashkëjetësat e regjistruara si të njëjta (ekuivalente) me martesën dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në legjislacionin e shtetit pritisë;
- (c) pasardhësit e drejtpërdrejtë të cilët janë nën moshën 21 vjeç ose janë në ngarkim dhe ata të bashkëshortit ose partnerit, siç përcaktohet në pikën (b);
- (d) paraardhësit e drejtpërdrejtë që janë në ngarkim ose të bashkëshortit ose të partnerit siç janë të përcaktuar në pikën (b);

Pra, ashtu si legjislacioni europian në ushtrimin e të drejtës për bashkim familjar legjislacioni shqiptar përcakton si anëtarë të familjes një kategori *solide* siç janë bashkëshorti, *partneri*, fëmijët e mitur, fëmijët në moshë madhore që janë në ngarkim dhe prindërit: për këto kategori familjarësh nuk ka hapësirë vlerësimi. Hyrja dhe qëndrimi në territorin e këtyre anëtarëve të familjes nuk lihet në diskrecion të Shtetit pritisë (Shqipëria). Ekziston edhe një kategori tjetër familjarësh për të cilët lejohet hyrja dhe qëndrimi për arsye të bashkimit familjar, atëherë kur Shteti Anëtar pritisë e parashikon në legjislacion: bëhet fjalë për a) çdo familjar tjetër, të çfarëdo kombësie në qoftë se është në ngarkim ose bashkëjeton me shtetasin komunitar në shtetin prej të cilit vjen dhe b) partneri me të cilin shtetasi komunitar ka një marrëdhënie të qëndrueshme dhe të vërtetueshme. Për këtë kategori rol thelbësor dhe deciziv ka shteti pritisë i cili rregullon hyrjen dhe qëndrimin e këtyre familjarëve, nëpërmjet legjislacionit të brendshëm. Këtu duhet të theksohet se shtetet e rregullojnë sipas politikave të tyre të brendshme që në disa raste janë favorizuese, ndërsa në disa raste të tjera janë kufizuese. Familjarët që mund të shoqërojnë të huajt shtetas jo komunitare përcaktohen në Ligj. Ata janë:

- a) bashkëshorti/ja e titullarit;
- b) fëmijët e mitur të titullarit dhe të bashkëshortit, duke përfshirë edhe fëmijët e birësuar në përputhje me një vendim të Shtetit Anëtar në fjalë, ose me një vendim automatikisht të detyrueshëm për shkak të detyrimeve ndërkombëtare ose që njihen në përputhje me detyrimet ndërkombëtare;
- c) fëmijët e mitur duke përfshirë të birësuarit, ku titullari aktiv ka kujdestarinë e tyre. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë bashkimin familjar të fëmijëve me prindër të divorcuar me kusht që pala tjetër për ndarjen e kujdestarisë ka dhënë pëlqimin e vet;

- d) fëmijët e mitur duke përfshirë të birësuarit, të bashkëshortit kur ka kujdestarinë e tyre. Shtetet Anëtare mund të autorizojnë bashkimin familjar të fëmijëve me prindër të divorcuar me kusht që pala tjetër për ndarjen e kujdestarisë ka dhënë pëlqimin e vet.

Kjo është korniza familjare e një familje të përbërë nga shtetasit jo komunitarë në kuadër të bashkimit familjar, pra familja e vogël. Shteti nuk mund të refuzojnë hyrjen dhe qëndrimin e familjes së përbërë në këtë mënyrë përveç rasteve kur anëtari i familjes përbën një kërcënim real dhe serioz për rendin publik, sigurinë kombëtare ose shëndetin publik. Shteti me ligj, ose akte ligjore të tjera të brendshme mund të autorizojnë hyrjen e të afërmeve të tjerë që janë:

- a) paraardhësit e drejtpërdrejtë të titullarit ose të bashkëshortit/es kur ata janë ekonomikisht të varur prej tyre dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës;
- b) fëmijët e rritur të pamartuar të titullarit ose të bashkëshortit/es, kur ata nuk janë objektivisht në gjendje për të siguruar nevojat vetjake për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore.

Në rast të një martese poligame, ku titullari e ka një bashkëshorte që jeton në territorin e një Shteti tjetër, Shteti ynë pritet nuk duhet të autorizojë bashkimin familjar të bashkëshortës së dytë. Pavarësisht nga sa fëmijë ka titullari në fjalë, ne e *kufizojmë* bashkimin familjar të fëmijëve të mitur të tij dhe të një bashkëshorte tjetër. Nuk ka rëndësi cilat nga bashkëshortet kërkon dhe përfiton bashkimin familjar.

Kjo dispozitë specifike është futur me një qëllim: duhet të ndalohen të gjitha rastet e familjeve poligame, edhe *de facto*, që realizohen në territorin e Shqipërisë, pasi këto martesë nuk janë të ligjshme në shume vende.

Në pothuajse të gjitha elementet e ligjit për të huajt kemi përputhje me legjislacionin europian perkates, edhe pse nuk specifikohet kategoria e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë. I vetmi ndryshim dhe mospërputhje haset në përcaktimin e saktë të kategorive si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kesaj të drejtë themelore.

## 5. Konkluzione dhe rekomandime

Regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë dhe jo komunitarë ndryshon. Kuptohet që bëhet fjalë për regjime të ndryshme juridike, të cilat

rregullohen nga akte të ndryshme ligjore. Në kuadër të bashkimit familjar familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin e regjistruar. Dhënia e një përkufizimi kategorik për familjen në tërësi në kuadër të bashkimit familjar është disi e vështirë. Këtë nocion, më shumë se legjislacioni komunitar, e kushtëzon legjislacioni i brendshëm dhe jurisprudenca komunitare ose ajo e brendshme. Para së gjithash është e vështirë të flasim për një anëtarësi të qëndrueshme të familjes. Në këtë drejtim edhe përcaktimi i situatave të veçanta apo i statusit të personave që përcaktojnë përbërjen e familjes, ndryshojnë në varësi të titullarit aktiv (shtetas komunitar ose jo komunitar). Nuk ka dyshim që disiplinat në fjalë janë subjekt i përmirësimeve dhe, në këtë drejtim me qëllim përparimin dhe harmonizimin e politikës së bashkimit familjar.

Duhet thënë se regjimi juridik i bashkimit familjar i shtetasve komunitarë dhe jo komunitarë ndryshon. Kuptohet që bëhet fjalë për regjime të ndryshme juridike, të cilat rregullohen nga akte të ndryshme ligjore. Në kuadër të bashkimit familjar familja komunitare është më e plotë dhe më e mbrojtur dhe përfshin jo vetëm bashkëshortin por edhe partnerin e regjistruar. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes dhe qëndrimit të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritës dhe jo atij dërgues. Që këtu lindin problemet e unifikimit të legjislacioneve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka. Zgjidhja më e përshtatshme në këtë drejtim është ulja e shkallës së mbrojtjes në përputhje me rregullat e shtetit pritës. Rregullat komunitare në lidhje me bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë janë në hapat e para, rregulla këto që janë subjekt i përmirësimeve ligjore dhe jurisprudenciale. Bashkimi familjar është një e drejtë që garantohet edhe në vendin tonë: është instituti me anë të të cilit shtetasit e huaj që jetojnë dhe punojnë në vendin tonë bashkohen me familjarët e tyre, që vijnë nga vende të tjera dhe ky bashkim realizohet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në pothuajse të gjitha elementet e ligjit për të huajt kemi përputhje me legjislacionin europian perkates, edhe pse nuk specifikohet kategoria e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë. I vetmi ndryshim dhe mospërputhje haset në përcaktimin e saktë të kategorive si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji në fjalë e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kesaj të drejtë themelore. Ajo që vlen të cilësohet si një arritje tjetër e vërtetë është fakti që të drejtat themelore që gëzojnë anëtarët e familjes së bashkuar, shtetas jo komunitarë, janë plotësisht të njëjta dhe të barabarta me ato të anëtarëve të shtetasve komunitarë. Përmendim në këtë drejtim të drejtën për punësim, të drejtën për qëndrim, të drejtën për formim dhe trajnim profesional etj. Legjislacioni ynë është me i plote dhe me favorizues se dhe legjislacionet e vendeve anetare të BE-së. I njejtë regjim shihet edhe në lidhje me shtetasit amerikane, pavarësisht se kjo kategori nuk është në fokus të këtij studimi. Rregullimi ligjor i lejimit të hyrjes

dhe qëndrimin të partnerëve *de facto* i lihet në dorë Shteteve Anëtare. Ky është një diskrecion i shtetit pritës dhe jo atij dërgues. Pikërisht këtu lindin problemet e unifikimit të legjislationeve, edhe pse në realitet unifikim nuk ka. Japim ketu disa rekomandime:

Rregullat komunitare në lidhje me bashkimin familjar të shtetasve jo komunitarë edhe në vendin tone janë subjekt i përmirësimeve ligjore dhe jurisprudenciale në varesi të ndryshimeve sociale, politike dhe ekonomike.

Zgjidhja më e përshtatshme në këtë drejtim do të ishte ulja (ose rritja) e shkallës së mbrojtjes në përputhje me rregullat e shtetit pritës. Vendi yne lejon bashkimin familjar të shtetasve të huaj edhe me partneret, pra është në tejkallim edhe të realitetit të vendeve të BE-se. Për këtë arsye, rekomandimi me këtë pjesë lidhet me pjesën procedurale dhe jo legjislative.

Mbrojtja e të drejtave lidhur me lëvizjen e lirë dhe respektimin e jetës familjare dhe bashkimin familjar duhet të orientojnë politikën komunitare jo vetëm drejt objektivit për të harmonizuar ndërkombëtarisht zgjidhjet, por, në veçanti, për të shmangur situata juridike të tilla jo favorizuese, të njohura në disa shtete komunitare.

Në lidhje me shtetasit ekstra-komunitarë duhet të merren masat e duhura që t'u sigurojnë atyre të drejta (thuajse) të barabarta me ato të shtetasve të BE –së.

Legjislationi shqiptar lidhur me bashkimin familjar edhe pse rezultoi të jetë në përputhje me legjislationin evropian përkatës, nuk e perfshin kategorinë e fëmijëve të rritur që janë në ngarkim të prindërve refugjatë.

Në legjislationin shqiptar për të huajt duhet t'i meshojmë thjeshtesimit të procedurave lidhur me dokumentacionin si ato të gjendjes civile, të cilat kanë rezultuar problematike lidhur me kategorinë e refugjateve në vecanti.

Duhet të krijohet një përcaktim i saktë i kategorive: si për shembull nuk thuhet qartë fëmijët e bashkëshortit, prindërit në ngarkim, fëmijët e rritur etj. pasi ligji aktual e vë theksin më tepër në përcaktimin e procedurave të aplikimit, kërkesave dhe mënyrën e ushtrimit të kësaj të drejtë themelore.

Në lidhje me autoritetet dhe strukturat shtetësore që merren me të huajt dhe refugjatët, duhet të reformohet sistemi dhe të shkohet drejt një institucion i sa më unik për trajtimin e çështjeve të tyre, përfshirë këtu edhe bashkimin familjar. Kjo do të lehtësonte trajtimin dhe specializimin e personelit dhe zgjidhjen e çështjeve për të huajt brenda të njëjtit institucion e do të shmange vonesat në lidhje me zgjidhjet përkatëse. Një model i tillë gjendet në disa nga vendet më të përparuar të BE si psh Holanda. Po kështu kjo do të shmange edhe moskuptimet mbi ndërhyrjen e kategorisë së refugjateve në fushat që lidhen me të drejta të cilat refugjatët duhet t'i gëzojnë

Në lidhje me bashkimin familjar, Ministria e Jashtme dhe ajo e Brendshme duhet të nxjerrin akte të qarta nënligjore, të ndryshueshme vetëm nga reformat tërësore

institucionale të cilat i japin zgjidhje çështjes së dokumenteve të paraqitshme, duke pasur parasysh gjendjen e veçantë të refugjateve, ambasadat ku familjarët mund të drejtohen dhe çështjen e numrit të kufizuar të përfaqësive diplomatike e konsullore të RSH nëpër botë, me gjithë pengesat që kjo sjell për paraqitjen personalisht të personave atje.

Në lidhje me dokumentet e gjendjes civile, organet përkatëse të gjendjes civile duhet të sigurojnë menjëherë zbatimin e ligjit dhe lëshimin e këtyre dokumenteve për refugjatët, duke qenë se thjesht rregjistrimi në gjendjen civile, pas asnjë impakti tek personat që janë në nevojë për këto dokumenta, mbetet pa kuptim dhe nuk mund të quhet arritje.

## Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë  
 Direktiva 2004/38/KE  
 Direktiva 2003/86/KE  
 Ligji nr. 9959 datë 18.7.2008 “Për të huajt”  
 Ligji nr. 8432 datë 14.12.1998 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”  
 Ligji nr. 9098 datë 03.7.2003 “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfutur azil në Republikën e Shqipërisë”  
 COMPASSO A., *Extracomunitari in Europa. Immigrazione, razzismo xenofobia*, Roma, 1995  
 CONDINANZI M., LANG A., NASCIMBENE B., *Cittadinanza dell'Unione e libera circolazione delle persone*, ed. 2°, Milano, 2006  
 FERRARI BRAVO L.-E.MOAVERO MILANESI, *Lezioni di diritto comunitario*, Editoriale scientifica, 2000  
 GIUBBONI S.-G.ORLANDINI, *La libera circolazione dei lavoratori nell'Unione europea*, Torino, 2007  
 GUILD E., *The legal elements of European Identity – EU citizenship and Migration Law*, Kluwer Law International, 2004  
 IKONOMI L., *E drejta e migracionit*, Tiranë, 2011  
 LASOK K.P.E., *Law & Institutions of the European Union*, 7° ed., Butterworths, 2002  
 MANDRO A., MECAJ V., ZAKA T., FULLANI A., *E drejta familjare*, Tiranë 2006  
 OMARI L.-A.ANASTASI, *E drejta kushtetuese*, Tiranë, 2008  
 VILLANI U., *Istituzioni di diritto dell'Unione europea*, Bari, 2008  
 SIRIANNI G., *Il diritto degli stranieri all'unità familiare*, Perugia, 2004  
 ADINOLFI A., *La libertà di circolazione delle persone*, në G.Strozzi, (a cura di) *Diritto dell'Unione europea*, Torino, 2005, fq. 69-78  
 ADINOLFI A., *L'art. 39*, në *Il Codice della famiglia*, M.Sesta, 2007 fq. 370-378  
 BEYERS L., *“Italians” in Belgium: a unique process of changing positions and identities*, në *Studi Emigrazione*, 2005, fq. 762-788  
 BISCARO A., *Italia: ancora Paese d'emigrazione*, në *Undicesimo Rapporto sulle migrazioni 2005*, Milano, 2006 fq. 76  
 BOSCHIERO N., *Les unions homosexuelles à l'épreuve du droit international privé italien*, në *Rivista di diritto internazionale*, n. 1/2007, fq. 50-59

CALAMO SPECCHIA M., *Il Conseil Constitutionnel e la protezione dell'immigrato: la difficile cittadinanza dei diritti costituzionali "deboli" tra accoglienza e integrazione* në *Diritto Pubblico Comparato ed europeo*, 11/2006, fq. 1580-1587

CAMPIGLIO C., *Il diritto di famiglia islamico nella prassi italiana*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 2008, fq. 43-49

CALVO CARAVACA A.- CARRASCOSA GONZÀLES J., *I matrimoni tra persone dello stesso sesso*, në *La famiglia senza frontiere*. Atti del Convegno tenuto presso la Facoltà di Giurisprudenza dell'Università degli studi di Milano il 25.05.2007, a cura di S.Bariatti – A.Galizia Danovi, fq. 81-87

CARACCILO DI TORELLA E.- MASSELOT A., *Under construction: EU family law*, në *European Journal Law*, 2005, fq. 38-42

CARRILLO M., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi costituzionali*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 264-268

COLACINO N., *Il diritto al ricongiungimento familiare e la disciplina introdotta dalla Direttiva 2003/86/CE* në *L'Europa tra costituzione asilo e immigrazione* (a cura) di Saulle M.R., Napoli, 2004

CALAMO SPECCHIA M., *Il Conseil Constitutionnel e la protezione dell'immigrato: la difficile cittadinanza dei diritti costituzionali "deboli" tra accoglienza e integrazione* në *Diritto Pubblico Comparato ed europeo*, 11/2006, fq. 1580-1587

CAMPIGLIO C., *Il diritto di famiglia islamico nella prassi italiana*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 2008, fq. 43-49

DE SCHUTTER O., *Homophobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation*, (a cura di) European Union Agency for Fundamental Rights, 2008, fq. 67-79

DI PASCALE A.- PASTORE M., *Il recepimento delle direttive sul ricongiungimento familiare e sui soggiornanti di lungo periodo*, në *Diritto Immigrazione e cittadinanza*, 1/2007, fq. 16-23

FIBBI R., *Italiani in Svizzera: da Tschingg a persone frequentabili*, në *Studi emigrazione*, 2005, fq. 733-745

GÒMEZ E.E., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali e la Costituzione spagnola*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 267-275

GROENENDIJK K., *Legal concepts of integration in EU migration law*, në *European Journal of Migration and Law*, 2/2004, fq. 119-124

HAILBRONNER K., *Free movement of EU nationals and Union citizenship*, në CHOLEWINSKI R., R.PERRUCHOUD-E. MACDONALD, *International migration law*, The Hague, 2007, fq. 320-332

LAUROBA E., *La legge spagnola sul matrimonio tra omosessuali ed i principi del diritto civile spagnolo*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 272-281

MISSORICI M.-C.ROMANO, *Libertà di circolazione e soggiorno: i cittadini degli Stati terzi tra cittadinanza europea e politica delle migrazioni*, në *Rivista internazionale dei diritti dell'uomo*, n. 11/98, fq. 44-48

PALLARO P., *Coppie di fatto e ricongiungimento familiare nell'ordinamento comunitario: un nuovo indirizzo della Corte di giustizia?*, në *Diritto comunitario e degli scambi internazionali*, 2001 fq. 261-265

PIGNATELLI N., *Nozione di matrimonio e disciplina delle coppie omosessuali in Europa*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 260-268

ROSSI L.S., *I beneficiari della libera circolazione delle persone*, në *Foro italiano*, 1994, fq. 98-105

ROMBOLI R., *La legge spagnola sul matrimonio tra persone dello stesso sesso e la tutela delle coppie omosessuali in Italia. Note introduttive*, në *Foro Italiano*, 2005, fq. 256-261

RUBINACCI L., *La circolazione dei lavoratori nella Comunità economica europea*, në *La libera circolazione dei lavoratori*, Rassegna del lavoro, a cura del Ministero del lavoro e della previdenza sociale, Roma, 1962, fq. 11-23

SANNA C., *La direttiva 2004/38/CE relativa al diritto dei cittadini dell'Unione e dei loro familiari di circolare e soggiornare liberamente nel territorio degli Stati membri*, në *Rivista di diritto internazionale privato e processuale*, 42/2006, fq. 1167-1178

TRIFONE L., *L'ammissibilità di limiti parziali alla libera circolazione delle persone: la sentenza Oteiza Olazabal*, në *Il Diritto comunitario e degli scambi internazionali*, 42/2003, fq. 758-766

TOMASI L., *La nozione di famiglia negli atti dell'Unione europea e della Comunità europea*, në S.BARIATTI (ed.), *La famiglia nel diritto internazionale privato comunitario*, Milano, 2007 fq. 51-55.

#### Vendime të Gjykatës Europiane të Drejtësisë

Vendimi dt. 8 korrik 1992, çështja C-243/91, *Tanghavi*, në *Përmbledhjen Vjetore 1992*, fq. I-4401

Vendimi dt. 18 tetor 1990, çështjet e bashkuara C-297/88 dhe C-197/89, *Dzodzi* në *Përmbledhjen Vjetore 1990*, fq. I-3763

Vendimi dt.13 shkurt 1985, çështja 267/83, *Diatta c. Land di Berlino*, në *Përmbledhjen Vjetore 1985*, fq. 567.

Vendimi dt. 18 qershor 1987, *Lebon*, çështja 316/85, në *Përmbledhjen Vjetore 1987*, fq. 2811; vendimi dt. 17 qershor 1975, çështja 7/75, *Coniugi F k. Shtetit belg*, në *Përmbledhjen Vjetore 1975*, fq. 679.